

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6577
E martë, 5 prill 2022
çmimi 0.40 €

“KOMPASI STRATEGJIK” (KOMIK) I BASHKIMIT EVROPIAN PËRBALLË “PATKOIT” GJENOCIDAL TË PUTINIT | FAQE 8

Milazim
KRASNIQI



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

NJË VIT NË KRYE TË PRESIDENCËS, VJOSA OSMANI
KA MBAJTUR KONFERENCË PËR MEDIE | FAQE 4

OSMANI: JEMI NË FAZËN E FUNDIT TË PËRGATITJEVE PËR APLIKIM NË KËSHILLIN E EVROPËS



Presidentja Vjosa Osmani ka shprehur optimizëm për anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës por, sipas saj, nga aplikimi deri në anëtarësim duhet një periudhë kohore. Osmani ka shprehur hezitim sa i përket anëtarësimit të vendit në NATO. Presidentja ka thënë se anëtarësimi në NATO mbetet qëllim strategjik i Kosovës. Osmani ka thënë se gjatë punës së saj njëvjeçare në Presidencë është angazhuar që zëri i Kosovës të dëgjohet edhe te vendet që nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës

Për 21 vjet u shkatërruan mbi 100 mijë mina | FAQE 7



KOSOVA DHE SHQIPËRIA AKUZOJNË RUSINË PËR KRIME LUFTE

| FAQE 3

AKTUALE



BANORËT E BUÇAS PËRSHKRUAJNË VRASJET “SISTEMATIKE” NGA FORCAT RUSE | F. 2

MË 12 PRILL KUVENDI DO TË DEBATOJË PËR POLITIKËN E JASHTME | F. 5

AKTAKUZË KUNDËR MINISTRES NAGAVCI | F. 6

EKONOMI



INICIOHET SHQYRTIMI I PROJEKTLIGJIT PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR ZYRTARËT PUBLIKË | F. 8

SPORT



INICIOHET SHQYRTIMI I PROJEKTLIGJIT PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR ZYRTARËT PUBLIKË | F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mobi: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Banorët e Buças përshkruajnë vrasjet “sistematike” nga forcat ruse

BUÇA, 4 PRILL - Banorët e Buças, në periferi të Kievit, i thanë “Radios Evropa e Lirë” se ia dolën që t’i mbijetonin vrasjes “sistematike” të popullsisë së këtij qyteti, që deri pak kohë më parë ishte nën okupimin e trupave ruse.

Imazhet e publikuara kanë shfaqur civilë të vrarë në Buça, qytet të cilin forcat ruse e kishin okupuar më herët gjatë këtij muaji. Ushtria ruse u largua nga qyteti më 1 prill. Pas publikimit të imazheve të vrasjeve të civilëve, komuniteti ndërkombëtar e ka dënuar Rusinë dhe madje ka pasur akuza për gjenocid dhe krime lufte.

Disa banorë lokalë i thanë “Radios Evropa e Lirë” se ajo që panë pasi dolën nga shtëpitë e tyre me të hyrë trupat ushtarake ukrainase në qytet ishte “e tmerrshme”, pasi trupat e dhjetëra civilëve që ishin vrarë, ishin të shtrirë nëpër rrugë.

Një person tha se një snajperist rus qëllimisht kishte vrarë disa persona në këtë zonë, përfshirë edhe një

familjar të tij. “Një snajperist filloi të qëllonte në këtë zonë më 5 mars”, tha ky person. “Kur ne u larguam nga shtëpia atë ditë para orës policore, dhëndëri im u vra me snajper. Pas kësaj filloi gjithçka, ata filluan të shtinin ndaj personave që gjendeshin jashtë”, tha ky banor.

Një tjetër banor i Buças tha se ka parë ushtarët rusë duke vrarë tre civilë dhe shtoi se ushtarët i qëlluan ata pa asnjë arsye. “Pasi e qëlluan njërin, ata hodhën një granatë në trupin e tij. Më vonë ne varrosëm mbetjet mortore të tij... ishte e tmerrshme”, tha ky person, duke shtuar se edhe vëllanë e tij e kishin vrarë teksa ai ishte duke shkuar në një strehimore më 5 mars.

“Kishte një sistem”, tha ky person. “Ata po i vrisnin njerëzit në mënyrë sistematike. Personalisht kam dëgjuar se si një snajperist mburrej se kishte vrarë dy persona që i kishte parë përmes një dritareje të një banese... Nuk kishte nevojë, nuk kishte asnjë justifikim



ushtarak për të vrarë... ishte thjesht për t’i torturuar civilët. Në një lagje tjetër banorët u torturuan. Ata u gjetën me duar të lidhura pas shpine dhe ishin qëlluar me plumba pas koke”.

Kryetari i Buças, Anatoliy Fedoruk, tha më 2 prill se afër

300 banorë lokalë janë vrarë gjatë okupimit rus të këtij qyteti dhe afër 280 trupa janë gjetur në një varrezë masive.

Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm të Ukrainës tha më 3 prill se prokurorët po hetojnë rastet për krime të dyshuara lufte nga Rusia dhe thanë se kanë gjetur 410 trupa në qytet dhe se 140 prej tyre ishin ekzaminuar.

Rusia ka mohuar se forcat e saj kanë qenë të përfshira në këto vrasje dhe kanë thënë se këto pretendime janë “provokim”.

ShBA-ja kërkon që Rusia të largohet nga Këshilli për të Drejtat e Njeriut

Uashington, 4 prill - Shtetet e Bashkuara po kërkojnë pezullimin e Rosisë nga Këshilli për të Drejtat e Njeriut i Kombeve të Bashkuara pas raportimeve se forcat ruse kanë vrarë dhjetëra civilë në qytetin ukrainas të Buças. “Pjesëmarrja e Rosisë në Këshillin për të Drejtat e

Njeriut është farsë”, tha ambasadorja amerikane në OKB, Linda Thomas-Greenfield, gjatë vizitës më 4 prill në Bukuresht të Rumanisë. Ajo po viziton Rumaninë për të parë se si ky shtet, që gjendet në kufi me Ukrainën, po përballlet me valën e refugjatëve ukrainas. “Është gjë e gabuar, prandaj ne besojmë se është koha që Asambleja e Përgjithshme e OKB-së të votojë për t’i larguar ata [rusët]”, tha ajo.

Largimi i Rosisë nga ky këshill, që ka selinë në Gjenevë, kërkon votat e të paktën dy të tretave të 193 anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme. Mocioni për largimin e një shteti nga ky këshill mund të merret parasysh nëse gjendet se shteti ka kryer shkelje sistematike të të drejtave të njeriut në kohën sa ka qenë anëtar i këshillit.

Rusia, që është në vitin e dytë të mandatit trevjeçar në këtë këshill, nisi pushtimin e Ukrainës më 24 shkurt.



Suedia miraton dozën e katërt për mbi 65-vjeçarët

STOKHOLM, 4 PRILL - Suedia ka rekomanduar dozën e katërt të vaksinës kundër koronavirusit për banorët e moshës mbi 65-vjeçare si dhe për ata që jetojnë në shtëpi të të moshuarve.

Në këtë rekomandim përmendet që doza e katërt mund të jepet edhe për banorët e moshave 18-64 të cilët kanë imunitet të dobët.

“Synimi është që, sikurse më herët, ta parandalojmë sëmundjen serioze dhe vdekjet nga Covid-19”, ka thënë Karin Tegmark Wisell, udhëheqëse e Agjencisë për Shëndetin Publik në Suedi.

Ajo ka thënë se marrja e dozës së dytë përforcuese është e nevojshme pasi infektimet në Suedi dhe shtetet e tjera vazhdojnë të rriten dhe

mbrojtja nga vaksina ka nisur të zvogëlohet te personat më të moshuar.

“Për njerëzit mbi moshën 65-vjeçare tani kanë kaluar katër muaj prej marrjes së dozës paraprake dhe mbrojtja nga vaksina bie pas një kohe”, ka thënë ajo.

Në pjesën më të madhe të pandemisë, Suedia ka pasur qasje tjetër nga kombet

evropiane. Ajo nuk ka zbatuar kurrë izolimin dhe as nuk ka mbyllur bizneset, duke e lënë kujdesin në duart e vet banorëve.

Ndonëse numri i vdekjeve me koronavirus në Suedi është më i lartë sesa në shtetet e tjera nordike, shifrat janë më të ulëta sesa në shumë vende të tjera të Evropës, të cilat kanë zbatuar disa herë masa izolimi.



27 raste të reja me Covid

PRISHTINË, 4 PRILL (ER) - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit, pas 752 testeve, 27 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19 dhe nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes. Të hënën janë shëruar 30

qytetarë, ndërsa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 223 890. Në total numri i rasteve aktive është 552. Në 24 orët e fundit janë dhënë 13 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë

dhënë 1 822 710 doza të vaksinës. Deri më sot 820 684 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë. Deri më sot janë dhënë 100 228 doza përforcuese dhe doza të treta të vaksinës kundër Covid-19.



Kosova dhe Shqipëria akuzojnë Rusinë për krime lufte



EPOKA
ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 4 PRILL - Liderët e Kosovës dhe të Shqipërisë kanë dënuar ashpër ato që kanë thënë se janë të dhëna për vrasjet brutale të civilëve ukrainas nga trupat ushtarake të

Rusisë. Të dyja shtetet kanë bërë thirrje që bota ta mbajë Rusinë përgjegjëse për këto ngjarje. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se trupat që janë gjetur në Buçë ia rikujtojnë mizoritë e ngjashme që janë kryer në periudhën 1998-1999 në luftën

mes luftëtarëve të pavarur shqiptarë dhe forcave serbe. "Varrezat masive, njerëzit e vrarë brutalisht, dhe me pjesë të zhdukura të trupit, shtëpi të djegura dhe qytete të shkatërruara, janë skena të njohura nga regjimet që kryejnë gjenocid", ka thënë Kurti

në "Twitter". Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka thënë se trupat që janë gjetur pasi ushtarët rusë janë larguar nga Buçë, afër Kievit, janë "shokuere" dhe ka bërë thirrje për hetime të pavarura "të këtyre krimeve të tmerrshme". "Asgjë nuk

mund ta arsyetojë këtë mizori. Çfarë dhimbje dhe çfarë turpi", ka shkruar ai në "Twitter". Kosova dhe Shqipëria u janë bashkuar sanksioneve të ashpra ndaj Rusisë, të cilat janë vendosur nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian.

Vuçiqi i fiton zgjedhjet në Serbi

BEOGRAD, 4 PRILL - Lista "Aleksandër Vuçiq - së bashku mund të bëjmë gjithçka" ka fituar më së shumti vota në zgjedhjet e parakohshme parlamentare në Serbi, të cilat janë mbajtur të dielën. Me mbi 87 për qind të votave të numëruara lista e presidentit serb ka fituar 43.4 për qind të tyre, ka bërë me dije Komisioni Republikan i Zgjedhjeve. Në vend të dytë ka dalë koalicioni "Të bashkuar për fitoren e Serbisë" me 13.1 për qind të votave dhe në vend të tretë ka dalë Partia Socialiste e Serbisë me 11.7 për qind. Koalicioni i Shqiptarëve i Shaip Kamberit ka marrë 0.28 për qind të votave dhe besohet se ka siguruar një vend

në Kuvendin e Serbisë. Të dielën në Serbi janë mbajtur edhe zgjedhjet presidenciale dhe në bazë të gati 87 për qind të votave të numëruara, presidenti aktual, Vuçiq, ka fituar 59.5 për qind të tyre. Në vend të dytë ka dalë Zdravko Ponoš me 17.5 për qind, ndërsa në të tretin Millosh Jovanoviç me 5.8 për qind të votave. Rezultatet preliminare të zgjedhjeve do të bëhen me dije mbrëmjen e sotme nga Komisioni Republikan i Zgjedhjeve, ndërsa përfundimet do të publikohen më së largu më 7 prill. Afati i fundit për ndarjen e mandateve është data 17 prill dhe Kuvendi duhet të konstituohet më së voni deri më 7 maj.



Për tri ditë në Emergjencën e OKUK-së kërkuar trajtim mjekësor 560 persona

PRISHTINË, 4 PRILL (ER) - Klinika Emergjente në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës ka trajtuar qindra pacientë në tri ditët e fundit të javës së shkuar. Bazuar në të dhënat për datat 1, 2 dhe 3 prill 2022, aty kanë kërkuar trajtim mjekësor 560 qytetarë. Në

Dhomën e Reanimimit (Dhoma e Kujdesit të Avancuar Emergjent) kanë marrë shërbime mjekësore 126 pacientë. "Te 113 persona janë kryer intervenime kirurgjike, ndërsa 179 të tjerë janë trajtuar si raste internistike. Në Dhomën e Shërbimit

Ortopedik, ndërkaq, për tri ditë janë trajtuar 104 pacientë. Si pasojë e aksidenteve në komunikacion, ndihmë mjekësore kanë kërkuar, sipas raportit të punës, 35 persona", ka njoftuar Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës.





NJË VIT NË KRYE TË PRESIDENCËS, VJOSA OSMANI KA MBAJTUR KONFERENCË PËR MEDIE

Osmani: Jemi në fazën e fundit të përgatitjeve për aplikim në Këshillin e Evropës

Presidentja Vjosa Osmani ka shprehur optimizëm për anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës por, sipas saj, nga aplikimi deri në anëtarësim duhet një periudhë kohore. Osmani ka shprehur hezitim sa i përket anëtarësimin të vendit në NATO. Presidentja ka thënë se anëtarësimi në NATO mbetet qëllim strategjik i Kosovës. Osmani ka thënë se gjatë punës së saj njëvjeçare në Presidencë është angazhuar që zëri i Kosovës të dëgjohej edhe te vendet që nuk e kanë njohur pavarësinë

**EPOKA
ERE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 4 PRILL- Të hënën është bërë një vit prej që Vjosa Osmani mori detyrën e presidentes së Kosovës. Në një paraqitjeje për medie, Osmani ka thënë se vendi është duke punuar për anëtarësimin në organizata ndërkombëtare.

Presidentja ka shprehur optimizëm për anëtarësimin e vendit në Këshillin e Evropës por, sipas saj, nga aplikimi deri në anëtarësim duhet një periudhë kohore. “Ne tashmë kemi dakordimin si institucione, dhe unë si drejtuese e politikës së jashtme kam kërkuar që sivjet të bëhet aplikimi për anëtarësim në Këshillin e Evropës. Jemi në fazën e fundit të përgatitjeve për aplikim, por ta keni parasysh se për anëtarësimin në Këshillin e Evropës, shteteve të ndryshme u është dashur kohë e ndryshme për pranim. Dikujt i është dashur një vjet e dikujt tjetër pesë vjet për anëtarësim. Ne po punojmë

që me partnerët tanë kjo kohë të jetë sa më e shkurtër”, ka thënë ajo, duke shtuar se më shumë se 2/3 e shteteve anëtare të këshillit të Evropës e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. “Ne shpresojmë se këto shtete do të votojnë në favorin tonë”, ka deklaruar Osmani.

Mirëpo Osmani ka shprehur hezitim sa i përket anëtarësimin të vendit në NATO. “Anëtarësimi në NATO është proces shumë më i komplikuar pasi kërkon votim dhe vendim me unanimitet. Në NATO ende janë katër shtete që nuk e kanë njohur Kosovën, kurse hapat tanë janë që të sigurohemi se i plotësojmë kriteret për anëtarësim në këtë organizatë”, ka pohuar ajo.

Presidentja ka thënë se, megjithatë, anëtarësimi në NATO mbetet qëllim strategjik i Kosovës.

Osmani ka theksuar se Kosova synon anëtarësimin në PFP (Partneriteti për Paqe) por, sipas saj, edhe këtu janë të përfshira Serbia dhe Bjellorusia.

“Jam angazhuar që zëri ynë të dëgjohej edhe te vendet që nuk e kanë njohur Kosovën”

Osmani ka folur në këtë konferencë edhe për punën e saj si presidente për një vit sa e mban këtë pozitë. “Viti i kaluar, po aq sa ka qenë i veçantë, është karakterizuar edhe nga shumë sfida lokale dhe globale. Pandemia, kriza energjetike dhe zhvillimet e fundit në kontinentin evropian. Kosova është sot kontribuuese aktive dhe anëtare e respektuar e komunitetit ndërkombëtar”, ka thënë Osmani. Si udhëheqëse e politikës së jashtme, Osmani shprehet se ka punuar për të siguruar që të përfaqësohemi me dinjitet dhe krenari në çdo cep të botës. Ajo përmendi vizitat në gjermani, Zvicër, ShBA, Shqipëri, Austri, Slloveni, Portugali, Estoni, Kanada, Belgjikë, Turqi, Japoni,

Maltë e vende të tjera, në të cilat ka zhvilluar dhjetëra takime me krerë të shteteve. Sipas saj, në çdo takim është përpjekur për përmirësim të imazhit dhe subjektivitetit të Kosovës. “Jam përpjekur maksimalisht që, krahas me përmirësimin e imazhit ndërkombëtar të vendit, të punoj edhe për subjektivitetin ndërkombëtar. Politika jonë e jashtme mbetet reflektim edhe i asaj se sa jemi shtet i fuqishëm përbrenda, prandaj kam mbrojtur në çdo takim e në çdo rast interesat e shtetit sovran të Kosovës, duke paraqitur njëkohësisht potencialin e jashtëzakonshëm të vendit tonë - të rinisë sonë të mrekullueshme”, ka thënë ajo, duke shtuar se ashtu siç ka thënë edhe presidenti Biden së fundmi, “Kosova vazhdimisht ka treguar, edhe përgjatë këtij viti leadership në arenën ndërkombëtare”. “Vendi ynë mbetet i palëkundur në orientimin euroatlantik dhe këtë po e dëshmon çdo ditë me veprime konkrete. Përgjatë kësaj periudhe kam takuar edhe përfaqësues të shteteve jonjohëse, të cilat, për arsye strategjike, duke kërkuar mirëkuptimin tuaj, do të bëhen publike sapo të kemi rezultate konkrete”, ka deklaruar Osmani. Ajo ka thënë se po punojnë vazhdimisht për avancimin e

rrugës drejt integritimit euroatlantik.

Ajo ka folur edhe për vazhdimin e bashkëpunimit me ShBA-në. “Me Shtetet e Bashkuara dhe ushtritë e tjera partnere po zhvillojmë diskutime për bashkëpunim bilateral ushtarak dhe në çdo vizitë timen jashtë vendit, por edhe kur kam pritur mysafirë këtu brenda, kam iniciuar thellim të bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, dhe kjo është bërë edhe më e domosdoshme, siç e dini, me zhvillimet e fundit në kontinentin tonë”, ka thënë Osmani.

Osmani ka theksuar se gjatë punës së saj njëvjeçare është angazhuar edhe për fuqizimin e rolit të gruas në shoqëri, për ndërgjegjësimin dhe adresimin e sfidave me të cilat përballen femijet me nevoja të veçanta dhe për rritjen e vetëdijes mbi kërcënimet që i kanosen shëndetit tonë nga shkatërrimi i ambientit. “Pres të punojmë drejt arritjeve të sukseseve të reja. Do të vazhdoj të punoj për ta udhëhequr politikën e jashtme dhe për t’i treguar botës që Kosova është më shumë sesa dinamikat e përditshme politike dhe që është një vend paqedashës”, ka thënë Osmani në fund të konferencës për medie.

Inicohet shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për zyrtarët publikë

EPOKA
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 4 PRILL - Nën kryesimin e kryetares Doarsa Kica-Xhelili, Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal ka mbajtur të hënën mbledhjen e radhës, në të cilën ka shqyrtuar në parim të Projektligjin për ndryshimin dhe

plotësimin e ligjit për zyrtarët publikë.

Kryetarja Kica, duke u thirrur në nenin 56 të rregullores së Kuvendit, ka bërë me dije se ky komision është ngarkuar për ta shqyrtuar në parim këtë iniciativë ligjore, e iniciuar nga gjashtë deputetë të grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje.

Për ta prezantuar dhe arsyetuar

njëkohësisht projektligjin në fjalë, Mimoza Kusari-Lila para anëtarëve të komisionit ka thënë se propozimi për plotësim-ndryshim të Ligjit nr. 06/L-114 për zyrtarët publikë ka për qëllim që ta plotësojë dhe ndryshojë ligjin aktual, nenin 22, paragrafin 6, duke përfshirë personelin akademik të universiteteve nga obligimi që ta pezullojnë marrëdhënien e punës me rastin e

zgjedhjes si deputet/e, nga data e certifikimit të tyre. Sipas saj, kjo nismë ligjore fokus primar ka ruajtjen e cilësisë së mësimdhënies në universitet dhe mosshkëputjen e personelit akademik nga procesi arsimor, duke iu mundësuar kështu vazhdimin e procesit mësimor, në mënyrë që studentët të vazhdojnë të përfitojnë nga përvoja dhe angazhimi i tyre.

Duke e vlerësuar si të domosdoshëm këtë plotësim-ndryshim, anëtarët e komisionit njëzëri votuan për dhe i njëjti procedohet për seancë plenare. Fare në fund anëtarët e komisionit formuan edhe dy grupe punuese për monitorimin e dy ligjeve që janë nën mbikëqyrjen e këtij komisioni, të cilat do të asistohen edhe nga stafi i organizatës Demokraci +.

Inicohet shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për zyrtarët publikë

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 4 PRILL - Kryesia e Kuvendit të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur të hënën, ka vendosur që seanca e radhës e Kuvendit të mbahet të enjten, më 7 prill, në orën 10:00.

Seanca do të fillojë me pikat e zakonshme, deklarimet jashtë rendit të ditës dhe pyetjet

parlamentare, për të vijuar me shqyrtimin e parë të dy projektligjeve: Projektligjit nr. 08/L-136 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, si dhe Projektligjit nr. 08/L-102 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për procedurën përmbartimore, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 05/L-118.

Do të shqyrtohet edhe Projektligji nr. 08/L-128 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-114 për zyrtarët publikë.

Në rend të ditës së kësaj seance do të jetë edhe shqyrtimi i Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) 2022-2026, zgjedhja e një anëtarit të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga radha e komunitetit

serb, si dhe formimi i Komisionit Ad-Hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një anëtar të Komisionit të Pavarur të Medieve nga radhët e komunitetit shqiptar. Ndërkaq të martën, më 12 prill 2022, Kuvendi, në një seancë të veçantë, do të debatojë për politikën e jashtme.

Kryesia në mbledhjen e sotme shqyrtoi dhe miratoi Planin Strategjik të Kuvendit të

Republikës së Kosovës për periudhën 2022-2025, si dhe raportin e shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2021.

Kryesia, po ashtu, vendosi që konform rekomandimit të Komisionit Ad-hoc, të shpallet konkursi për një anëtar të Bordit për Ankesa të Medieve, si dhe shqyrtoi çështje të tjera nga fushëveprimtaria e saj.

Komuna e Prishtinës nis lirimin e hapësirave publike

PRISHTINË, 4 PRILL (ER) - Komuna e Prishtinës ka ndërmarrë të hënën një veprim për lirimin e hapësirave publike. Nën kryetari i Prishtinës, Alban Zogaj, në një postim në

llogarinë e vet në "Twitter", ka shkruar se ky është prioriteti i qeverisjes së tyre. "Hapësirat publike po lirohen. Ky është prioriteti i qeverisjes sonë", ka shkruar Zogaj. Ndërkaq në fotografitë e publikuara

shihen teksa largohet nga oborri i kompleksit universitar, një orë e vendosur nga disa kompani private, po ashtu një e tillë është larguar edhe në afërsi të objektit të komunës së Prishtinës.



Aktakuzë kundër ministres Nagavci

PRISHTINË, 4 PRILL (ER) - Arbërie Nagavci, ministre e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHIT), së shpejti pritet të dalë para gjykatës lidhur me akuzën se ka kryer veprën penale "Mbjajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve". Nagavci është duke u akuzuar se më 21 mars të vitit 2018, gjatë mbajtjes së seancës në Kuvendin e Kosovës në të cilën ishte hedhur gaz lotsjellës, gjatë kontrollimit nga policia asaj i ishte gjetur një sprej ngjyrë e gjelbër me pjesë spërkatëse të zezë. Nagavci ka thënë se nga mediet është njoftuar për ngritjen e aktakuzës ndaj saj. "Duhet të shpreh keqardhje se si është e mundur që institucionet

përgjegjëse të mos njoftojnë personin ndaj të cilit është ngritur aktakuzë para çdokujt tjetër. Për aq sa u njoftova nga mediat, aktakuzë ka të bëjë me angazhimin tonë në kundërshtim të marrëveshjeve të dëmshme, përkatësisht 'Zajednicë' e 'Demarkacion', njëra që cungonte sovranitetin, tjetra territorin e Kosovës. Nëse asokohe isha e sigurt, sot në vitin 2022 jam edhe më e bindur se kundërshtimi dhe rezistenca, përveçse i drejtë, ishte edhe i domosdoshëm. Deputeti betohet për respektimin dhe mbrojtjen e Kushtetutës dhe pas vendimit të GJK-së më 2015 mosveprimi ndaj cenimit që po i bëhej vendit do të përbënte shkelje të betimit të deputetit", ka shkruar Nagavci në llogarinë e saj



në "Facebook". Ajo ka shtuar se teksa dëmet e këtyre marrëveshjeve jemi duke i

vuajtur edhe sot, ndihet krenare që ishte në anën e kundërt me politikën që sillte kompromise,

dëmtonte vendin dhe shkatërronte të ardhmen e qytetarëve.

Nënshkruhen kontratat e formësimit profesional për 16 nxënësit e Qendrës së Kompetencës në Skenderaj



SKENDERAJ, 4 PRILL (ER) - Janë nënshkruar kontratat e formësimit profesional për 16 nxënësit e Qendrës së Kompetencës në Skenderaj, të cilët do të angazhohen me punë në kompaninë vendore "R&Rukolli", me kushte të njëjta si punëtorë profesionalë, me pagë dhe përfitime të tjera, në profilet murator dhe pllakashtrues. Në këtë ceremoni të mbajtur të

hënën, kanë marrë pjesë kryetari i komunës, Fadil Nura, ministrja e Arsimit, Arbërie Nagavci, ministrja e Tregtisë, Rozeta Hajdari, drejtori për Arsim, Kastriot Duraku, përfaqësuesit e kompanisë "R&Rukolli", fondacionit "Besa" dhe të ftuar të tjerë. Kryetari Nura e ka përshëndetur nënshkrimin e kontratave, duke e quajtur rast të mirë për nxënësit, të cilët do të kenë

mundësinë e punësimit më afatgjatë pas periudhës së praktikës. "Një mundësi e mirë e punësimit afatgjatë për këta nxënës, pas periudhës së praktikës, dhe një kontribut i vogël që të pengohet ikja e të rinjve nga vendi", ka thënë kryetari i Komunës së Skenderajt. Edhe ministret e kanë vlerësuar hap të rëndësishëm nënshkrimin e kontratave.

Qytetarët e Rahovecit marrin ndihmë juridike falas

RAHOVEC, 4 PRILL (ER) - Si rezultat i bashkëpunimit të mirë në mes të komunës së Rahovecit dhe Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, qytetarët e komunës së Rahovecit nga 4 prilli do të marrin Ndihmë Juridike Falas, pasi në oborrin e komunës u vendos Klinika Mobile për ndihmë juridike falas. Të pranishëm në fillimin e punës së Klinikës Mobile për ndihmë juridike falas ishin Smajl Latifi,

kryetari i komunës së Rahovecit, Fatmir Iska, nënkryetari i komunës, Besarta Ademi-Ujkani dhe Samed Ademi, zyrtarë ligjorë në Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas. "Sot, në hapësirën e komunës së Rahovecit, u vendos Klinika Mobile për ndihmë juridike falas, e cila në dy muajt e ardhshëm do të jetë në shërbim të të gjithë qytetarëve të Rahovecit, që e kanë të pamundur t'i përballojnë shpenzimet juridike

për raste të ndryshme gjyqësore apo juridike. Ky projekt po zbatohet në bashkëpunim me Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas ndërkah, duke vlerësuar kërkesat dhe nevojat gjatë këtyre dy muajve të ardhshëm, synim mbetet vendosja e saj e përhershme brenda objektit të komunës së Rahovecit. Ftoj të gjithë qytetarët e komunës sonë që t'i shfrytëzojnë këto shërbime", ka thënë Latifi.



Lirohet nga detyra e drejtoresha për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi në Podujevë



PODUJEVË, 4 PRILL (ER) - Bahrie Shatrolli-Mehmeti është liruar nga detyra e drejtoreshës për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi për shkak të angazhimeve profesionale. Në këtë pozitë është emëruar Saranda Stublla.

Kryetari Bulliqi e ka falënderuar ish-drejtoreshën për punën dhe kontributin e saj në dikasterin që ka udhëhequr, ndërsa ish-drejtoresha e ka falënderuar kryetarin Bulliqi për besimin, bashkëpunimin dhe ka shprehur gatishmërinë e

plotë që ta ndihmojë komunën në aspektin profesional çdoherë. Kryetari Bulliqi, gjithashtu, e ka uruar drejtoreshën e re për detyrën dhe i ka uruar suksese në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësisë të saj.

Osmani dhe Kurti takojnë ministrin e Luksemburgut, pritet shtimi i raporteve mes dy vendeve

PRISHTINË, 4 PRILL (ER) - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani-Sadriu dhe kryeministri Albin Kurti kanë takuar të hënën ministrin për Bashkëpunim Zhvillimor dhe Çështje Humanitare të Luksemburgut, Franz Fayot. Presidenca ka njoftuar se gjatë takimit u bisedua për raportet dhe bashkëpunimin e Republikës së Kosovës me Luksemburgun si një nga kontribuuesit kryesor në projektet zhvillimore të cilat janë në dobi të qytetarëve të

Kosovës. Në veçanti, presidentja Osmani falënderoi mysafirin për angazhimin e Luksemburgut për kontributin e pashoq në fushën e shëndetësisë dhënë ndër vite, si dhe në fushën e arsimit. "Ministri Fayot vlerësoi progresin e gjithëmbarshtëm në Republikën e Kosovës, duke theksuar në veçanti angazhimin për luftim të korrupsionit dhe sundimit të ligjit. Palët u dakorduan për bashkëpunim të mëtejshëm në drejtim të zhvillimit të kapitalit njerëzor, dhe



diskutuan potencialin për investim në fushën e digjitalizimit, energjisë, si dhe në drejtim të mbledhjes dhe gjenerimit të të dhënave si parakushte për politikëbërje më efektive", ka njoftuar Presidenca e Kosovës.

Kryeministri Albin Kurti ka shprehur mirënjohjen e qeverisë për ndihmën dhe mbështetjen e dhënë vazhdimisht nga shteti i Luksemburgut. Duke e falënderuar për kontributin në zhvillimin e Kosovës, kryeministri Kurti theksoi

mundësitë e rritjes së mëtejme të bashkëpunimit ndërmjet dy shteteve.

Ministri Fayot e përgëzoi kryeministrin Kurti për të arriturat në vitin e parë të mandatit qeverisës, për stabilitetin institucional dhe përparimin në shumë fusha. Duke theksuar se ky përparim është inkurajues, ai tha se si vend mik e partner i vjetër, shteti i Luksemburgut, është i interesuar për të ndërmarrë hapa të mëtejshëm drejt bashkëpunimit në fusha të interesit të përbashkët. Ministri Fayot shprehu

interesimin për forcim të miqësisë, për rritje të bashkëpunimit afatmesëm dhe kalim nga perspektiva e zhvillimit, në partneritet të rregullt ndërmjet dy shteteve evropiane të barabarta.

Kurti foli për përparimin gjatë një vit qeverisjeje, për prioritetet e qeverisë si dhe për potencialin e bashkëpunimit në fushën e edukimit, digjitalizimit e transformimit të gjelbër.

Duke biseduar për tranzicionin energjetik dhe zhvillimin e kapaciteteve të reja energjetike të cilat ofrojnë siguri të furnizimit, kryeministri potencoi kapacitetet për energji të ripërtëritshme, me fokus të veçantë në atë diellore dhe të erës.

Kryeministri Kurti ka veçuar parkun e erës "Selac Windpark" me kapacitet prej 105 MW dhe 27 turbina, si dhe projektin "Solar4Kosovo" me kapacitet prej 70 MW, që njëherësh do të jetë një nga termocentralet më të mëdha diellore në Evropë, me sipërfaqe prej 69 mijë metrash katrorë.

Kurti ka theksuar se digjitalizimi është një nga objektivat e programit qeverisës që parashihet të jetë pjesë e të gjitha fushave të qeverisjes.



Për 21 vjet u shkatërruan mbi 100 mijë mina

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

FERIZAJ, 4 PRILL - Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka marrë pjesë në Ditën Ndërkombëtare për Ndërgjegjësimin ndaj Minave, në Parkun e Lirisë në Ferizaj.

Gjatë fjalës së tij Mehaj ka thënë se specialistët e çminimit janë heronjtë tanë. "Në këtë ditë të veçantë për specialistët e deminimit dhe asgjësimit të mjeteve të pashpërthyer, shpreh edhe njëherë mirënjohjen dhe vlerësimin maksimal për heronjtë e ditëve tona. Specialistët e deminimit vërtet janë heronjtë tanë sepse, pandërprerë, edhe 23 vjet pas lufte, ata janë ende në vijën e parë, përballë minave dhe mjeteve të tjera të pashpërthyer, që ne të tjerët të jemi të mbrojtur dhe të sigurt", ka thënë Mehaj. Ai ka theksuar se çminuesit e FSK-së,



të KFOR-it dhe organizatave të tjera janë profesionalë, vigjilentë

dhe të guximshëm dhe, sipas tij, ajo që i bënë të veçantë është se,

me misionin e tyre fisnik e lartësojnë uniformën ushtarake si

dhe e konfirmojnë betimin se mbi të gjitha janë detyra, nderi dhe atdheu.

Mehaj ka pohuar se çminuesit për 21 vjet detektuan dhe shkatërruan mbi 100 mijë mina e mjete të tjera të rrezikshme, pastruan mbi 60 milionë m² terren të minuar nga 4 500 pika të rrezikshme. "Me ligjëratat e realizuara në shkollat e Kosovës për vetëdijesim të fëmijëve ndaj minave dhe mjeteve piroteknike, Kompania e Deminimit ka arritur që të edukojë rreth 50 mijë nxënës në afro 1 000 shkolla. Urime edhe njëherë në këtë datë të veçantë, duke ju inkurajuar që të vazhdoni me misionin të shenjtë dhe sukseset tuaja të përhershme. Nga pozita ime do të kenë gjithmonë mbështetjen e plotë për secilën çështje me interes për mirëqenien e tyre si dhe realizimin sa më të mirë të misionit të shenjtë", ka deklaruar ministri Mehaj.

Hoxhaj: Kosova duhet ta ketë prioritet anëtarësimin në NATO

PRISHTINË, 4 PRILL (ER) - Ish-ministri i Jashtëm i Kosovës, Enver Hoxhaj, ka kujtuar 73-vjetorin e themelimit të NATO-s, duke thënë se tani është koha që Kosova ta ketë vetëm një prioritet, atë të anëtarësimin në këtë aleancë.

Hoxhaj në "Facebook" është shprehur se sot si kurrë më parë

rendi evropian është në kërcënim serioz, pas agresionit rus në Ukrainë dhe po aq është edhe siguria globale. "73 vjet nga themelimi i NATO-s, aleancës më të suksesshme në historinë moderne, në shërbim të sigurisë dhe paqes në botë. Sot, si kurrë më parë, rendi evropian është në kërcënim serioz, pas

agresionit rus në Ukrainë dhe po aq është edhe siguria globale. Tani Kosova duhet ta ketë vetëm një prioritet, anëtarësimin në NATO! Në këtë përvjetor shprehim mirënjohjen dhe falënderimin e përgjeshëm ndaj NATO-s për intervenimin që ndali gjenocidin e Serbisë në Kosovë", ka shkruar Hoxhaj.



'KOMPASI STRATEGJIK' (KOMIK) I BASHKIMIT EVROPIAN PËRBALLË 'PATKOIT' GJENOCIDAL TË PUTINIT

Tridhjetë e tre vjet pas rënies së Murit të Berlinit, Perëndimi ende ka krizë të formulimit të interesave të veta gjeostrategjike, ka edhe frikë neurotike nga Rusia



Milazim KRASNIQI

Pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, me fitoren spektakulare të Perëndimit ndaj ish Bashkimit Sovjetik, Perëndimi hyri në një periudhë vetëkënaqësie, ndërsa trashëgimtarja formale e BRSS, Rusia, e filloi një proces të nëndheshëm të përgatitjes për hakmarrje. Vetëkënaqësia e Perëndimit me fitoren, realisht ishte e pajustificueshme, sepse nuk ishte fitore me meritën ekskluzive të Perëndimit. Bashkimi Sovjetik më shumë u shkëmbi nga krizat e veta të brendshme, në rend të parë atyre ekonomike, nga eksperimenti me Perestrojken e Gorbaçovit dhe sidomos nga lëvizjet sociale si "Solidarnosti" polak, e jo nga konfrontimi ushtarak me Perëndimin. Për gjithë atë fitore spektakulare të Perëndimit, në fazën finale të ballafaqimit bllokist, praktikisht nuk u shkrep asnjë plumb.

Fitorja me lehtësi e Luftës së Ftohtë e vuri në gjumë Perëndimin

Garën ushtarake e politike me Perëndimin, BRSS (Rusia) e humbi, si pasojë e dështimit të socializmit si teori e si praktikë, si pasojë e lëvizjeve sociale, fetare e kombëtare në kombet e shteteve të Evropës Qendrore e Lindore, po edhe brenda vetë Bashkimit Sovjetik. Mirëpo, Perëndimi vazhdoi të viltë rezultatet e asaj shkëmbimeve të BRSS e të Traktatit të Vrahavës, si të ishte fitimtar absolut.

Me perceptimin e vetes si fitues absolut, Bashkimi Evropian dhe NATO e filluan procesin e anëtarësimit të ish shteteve satelite të Bashkimit Sovjetik në strukturat e veta, me një triumfalizëm të madh. Disa nga shtetet e Evropës Lindore, u pranuan pa plotësuar as kriteret minimale. Në fakt, as në projektin e anëtarësimit të tyre në BE e në NATO nuk u kërkua ndonjë vendosmëri e madhe dhe as investime të mëdha të Perëndimit, meqë opinioni publik në ato vende, si në Poloni, Çeki,

Hungari, Rumani, Bullgari, ishte në favor të afrimit me Perëndimit e bollëkut, ndërsa Rusia ishte në kolaps dhe bënte zhurmë vetëm me fjalë.

Në të vërtetë, anëtarësimi i këtyre shteteve në Bashkimin Evropian po edhe në NATO, i ofroi Perëndimit, jo vetëm përfitime gjeopolitike, po edhe përfitime të mëdha ekonomike, duke e bërë hisedar në privatizime dhe në investime në ato vende, që u emërtuan si demokraci të reja. Kësodore, pas pranimit të atyre shteteve në BE e në NATO, Perëndimi e kujtoi gati të mbyllur konfliktin me Rusinë. Perëndimi u koncentrua në problemet e veta organizative, duke e injoruar rrezikun nga rizgjimi i ariut rus. Shumë nga shtetet e Bashkimit Evropian zvogëluan buxhetet për mbrojtje, nën kuotën 2%, duke mos çarë kokën për aspektet e mbrojtjes, me bindjen naive se gara në armatim me Rusinë ishte e mbyllur, prandaj nuk konsiderohej se kishte nevojë të bëheshin shpenzime të panevojshme në atë sektor.

Bashkë me këtë triumf të vetëkënaqësisë, pasoi edhe arroganca e Perëndimit, veçmas e Bashkimit Evropian, kundër pjesës së vet më të varfër, kundër Ballkanit. Meqë përfitimet ekonomike nga Ballkani do të ishin më të vogla se sa nga Evropa Qendrore dhe ajo Lindore dhe meqë në Ballkan kishte edhe një problem shtesë, "problemi musliman", (që në esencë është një problem imagjinari i Perëndimit), atëherë u zgjodh politika e konservimit në krizë e tranzicion të këtij rajoni, ndonëse është rajon në zemër të vetë Evropës, fjala vjen, në krahasim me Qipron, Greqinë, Bullgarinë e Rumaninë. Në Samitin e Selanikut të vitit 2003, ndonëse u lansua mundësia e integritit dhe anëtarësimit në Bashkim Evropian të shteteve të Ballkanit Perëndimor, kjo gjë u injorua. Në fakt, prirja strategjike për ta injoruar rajonin e Ballkanit, u duk në formën më çnjerëzore në vitet 1991-1999, kur Bashkimi Evropian u tregua indiferent e indolent ndaj agresionit ushtarak dhe gjenocidit të Serbisë, veçmas në Bosnjë e Hercegovinë dhe në Kosovë. Bile sot është e qartë se po të mos aktivizoheshin administrata amerikane, në vitin 1995 në BeH dhe në vitin 1999 në Kosovë, spastrimi etnik dhe gjenocidi serb do të triumfonin në të dyja këto vende, ashtu që çrrënjosja e myslimanëve evropianë, e filluar nga Kongresi i Berlinit, do të ishte përfunduar në fund të shekullit XX.

SHBA largoi vëmendjen nga Rusia, për luftëra të kota me shtete të dështuara

Injorimi i Ballkanit nga Bashkimi Evropian, e sidomos nga Gjermania, bënë që këtu të fillonte të fillonte të rikthehej gradualisht ndikimi rus, si dhe të forcohej prezenca e Kinës, me anën e projekteve investuese. Pra, Bashkimi Evropian, qëllimisht e ka trajtuar Ballkanin Perëndimor si corpus alieni, si trup të huaj, për arsye të paragjykimave fetare në rend të parë, sikundër ka vepruar edhe në raport me Turqinë tash tre decaenie. Por, vetëkënaqësia dhe arroganca e Bashkimit Evropian pati një formë shfrenimi edhe në raport me daljen e Britanisë së Madhe nga BE-ja. Disa nga shtetet e BE-së, sidomos Gjermania e Franca, u ndien triumfuese, sepse po mbeteshin pa rival brenda strukturave të bashkimit. Në këtë kontekst, nuk duhet të shmanget nga vëmendja analitike, ndikimi që ka pasur Gjermania në Brexit, me projektin e udhëhequr nga "Zydojçe cajtung", për aferën globale "Letrat e Panamasë", ku u gjet i përfshirë babai i ish kryeministrit britanik, Dejvid Kamerunit. Pompimi i asaj afere të familjes kryeministore britanike, e dëmtoi rëndë ish kryeministrin, i cili po udhëhiqte fushatën për mbetjen e Britanisë në BE. Triumfi i egoizmit gjerman dhe cinizmit francez edhe në këtë rast, si në rastin e bashkëpunimit të njëanshëm ekonomik me Rusinë, që e rriti varësinë e ekonomisë evropiane nga humori i Putinit. Në prapavijë të këtyre zhvillimeve absurde, të injorimit të Ballkanit e të Turqisë, të përzënies së Britanisë nga BE, strategjia e nëndheshme e hakmarrjes ruse, si virusi anaerob që ka qëndruar fshehur e mbyllur, gjeti oksigjenin që i duhej që të shtonte virulencën e vet. Ajo virulencë nuk do të rritej aq shumë, po qe se SHBA nga ana e vet, do të mbante kujdestarinë e duhur ndaj Rusisë. Në fakt, Shtetet e Bashkuara, me ndjenjën e fituesit të Luftës së Ftohtë, realizuan intervenime të efektshme në Bosnjë e në Kosovë, duke e goditur rëndë influencën ruse në rajonin e Ballkanit. Por, as Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk e finalizuan fitoren kundër Rusisë në Ballkan. Përkundrazi, në momentin kur duhej të finalizoheshin fitorja mbi Rusinë e mbi komunizmin, SHBA u përfshi në luftën në Irak, me çka presioni vendimtar mbi Rusinë u shmang. Ndërsa para ndërhyrjes kundër

Irakut për Kuvajtin, me Marrëveshjen e Dejtonit për Bosnjën dhe me ndërhyrjen e NATO-s në Kosovë, SHBA bëri punë të madhe, por edhe atë e lanë të papërfunduar. Përfshirja e mëvonshme e SHBA-ve në luftën në Afganistan e Irak, sidomos në luftën e dytë në Irak, jo vetëm ia hoqi vëmendjen nga Ballkani e nga Evropa Lindore, po ia konsumoi një sasi enorme të resurseve ushtarake e ekonomike, si dhe e dëmtoi rëndë reputacionin e saj në arenën ndërkombëtare. Sipas disa përlogaritjeve, lufta në Irak i ka kushtuar SHBA deri në 300 miliardë dollarë, ndërsa lufta në Afganistan rreth dy bilionë dollarë. Nga ana tjetër, me faktin që në Irak nuk u gjetën armë të shkatërrimit në masë, për të cilat u justifikua pushtimi i Irakut, ishte dërrmues për pozitën morale të shtetit që ishte lider i demokracisë dhe lirisë. E vërteta është se SHBA u dërrmuan ushtarakisht dhe ekonomikisht në Irak e në Afganistan, pa ndonjë përfitim të madh strategjik: pushtimi i Irakut u bë nga një motivim ideologjik, ndërsa pushtimi i Afganistanit ishte një reagim tipik hakmarrës, për shkak të sulmeve terroriste të Al Kaidës në territorin e SHBA-së në vitin 2001. Dëmi për SHBA u ilustrua shumë qartë edhe nga largimi me një panik të paimagjinueshëm nga Afganistani.

Gjatë kësaj periudhe njëzetvjeçare të angazhimit të SHBA në Irak e në Afganistan, vëmendja dhe presioni i SHBA mbi Rusinë e edhe mbi Kinën ishte minimal, sepse energjia kryesore ishte e drejtuar në konfliktet e armatosura në ato dy vende. Si pasojë e kësaj, Rusia, po edhe Kina, shfrytëzuan dy decaenie të plota që të zhvillonin pothuajse të patrazuara projektet e tyre militariste. Rikthimi hakmarrës i Rusisë u manifestuar brutalisht në pushtimin/aneksimin e Krimesë (2014) dhe në ndërhyrjen gjenocidale në Siri. Por, simbol i rritjes së fuqisë dhe arrogancës antiperëndimore dhe sidomos antiamerikane, mbetet ndërhyrja ruse në zgjedhjet presidenciale amerikane të vitit 2016. Pra, derisa SHBA e kishin shmangur nga vëmendja humbësen e Luftës së Ftohtë e po merreshin me shtete të dështuara si Afganistani, Iraku e Siria, Rusia po rikthehej si hakmarrëse edhe ndaj vetë SHBA-së. Në ndërkohë Rusia ka realizuar jo vetëm pushtime në Gruz, Moldavi e në Ukrainë. Në Ballkanin Perëndimor Serbinë dhe entitetin R. Serpska i ka

shndërruar në vasal, ndërsa tentoi edhe dy grushshtete, një në Malin e Zi e tjetrin në Maqedoninë e Veriut. Pra, deri sa Bashkimi Evropian kishte fjetur i vetëkënaqur me bollëkun e vet, derisa SHBA ishte shkallmuar në dy luftëra të pakuptimta, ariu rus kishte filluar të kafshonte në të katër anët egërsisht. Kafshimi i tashëm në Ukrainë, e tregon fazën më virulente të tërbimit të tij.

Puna e lënë përgjysmë po e shkatërron edhe Ukrainën

Kjo përvojë me ish BRSS përkatësisht me Rusinë, ku Perëndimi u mjaftua me fitore të pjesshme, në Evropën Lindore dhe në Ballkan, e bën të qartë se fitoret e pjesshme janë të rrezikshme edhe për fituesit, sepse i japin motiv më të fortë humbësit, për të goditur sa më egërsisht, në momentin që i rishfaqet mundësia. Goditja mizore në Ukrainë është hakmarrje tipike ndaj prirjeve të saj perëndimore po edhe ndaj punëve të lëna përgjysmë të Perëndimit. Ukraina si edhe Ballkani Perëndimor është punë e lënë përgjysmë nga BE dhe nga NATO. Pse? Po qe se e analizojmë rastin e Ukrainës në këtë sfond, shihet se NATO dhe Bashkimi Evropian e kanë nxitur Ukrainën drejt politikave perëndimore, e kanë ndihmuar në atë drejtim, por jo në mënyrë vendimtare. E kanë lënë që procesi i integritit a anëtarësimit të tejzgjatet, pa i dhënë siguri konkrete. Bile në rastin e Ukrainës, Perëndimi ka bërë një gabim trashanik: në vitin 1994 e kanë detyruar Ukrainën që të dorëzojë tërë arsenalin bërthamor dhe të heqë dorë nga statusi i shtetit me armë bërthamore. Në Marrëveshjen e Budapestit, si garant për integritetin dhe sovranitetin e Ukrainës, kanë dalë Shtetet e Bashkuara dhe Britania e Madhe. Ukraina e ka dorëzuar tërë arsenalin bërthamor me atë garanci, ndërsa sot është viktimë e agresionit barbar ushtarak të Rusisë. Ndihma që po i afrohet nga SHBA, Britania e madhe, NATO e BE është e tërthortë, por jo në pajtim me Marrëveshjen e Budapestit. Ne sot mund të imagjinojmë se si do të ishte pozita e Ukrainës, po të posedonte arsenalin bërthamor, që e ka pasur dhe mund të konkludojmë se Putini nuk do të guxonte ta sulmonte Ukrainën me këtë egërsi me të cilën e ka sulmuar. Pra, sot kuptohet se sa e palogjikshme ka qenë çarmatosja

e aleatit të Perëndimit, Ukrainës, në favor të armikut të Perëndimit, Rusisë!

Disa shtete të BE e NATO-s, si aleatë të Rusisë kundër Kosovës

E njëjta qasje është edhe ndaj Kosovës, në rastin e Bashkimit Evropian. Pesë shtete të BE-së nuk e njohin Kosovën, duke u bërë palë me Rusinë, me Serbinë e me Kinën, që kanë plane diversioniste jo vetëm ndaj Kosovës po edhe ndaj Perëndimit, si të tillë. Bashkimi Evropian favorizon Serbinë në çdo nivel të bashkëpunimit, ndërsa Kosovën e mban të izoluar dhe nën presion permanent. Ndërsa sikundër dihet, Kosova dhe shqiptarët në tërësi janë më euroentuziastët në kontinent, ndërsa Serbia ka element të shtetit vasal të Rusisë. Absurditet më vete është që katër shtete të NATO-s, e cila ushtron mandat sigurie në Kosovë, nuk e njohin Kosovën, duke qenë ashtu edhe ato më afër pozicionit rus, serb e kinez se sa të vetë NATO-s! Me një fjalë, tridhjetë e tre vite pas rënies së Murit të Berlinit, Perëndimi ende ka krizë të formulimit të interesave të veta gjeostrategjike, ka edhe frikë neurotike nga Rusia.

Në kuadër të kësaj krize të Bashkimit Evropian, po e pësojnë aleatët e saj, siç janë Kosova, Bosnja, po edhe Turqia, ndërsa marrin favore satelitet e Rusisë, Serbia në rend të parë. Pse? Sepse mendimi politik në Evropë po e ndjek kurbën në rënie të mosveprimt në raport me mbrojtjen e identitetit divers evropian dhe në raport me pretendimet e armiqve të Evropës. Paradoksalisht, Bashkimi Evropian e pati një periudhë bukur të gjatë, kur armiq të vet i shihje më shumë britanikët dhe muslimanët e Ballkanit, se sa Rusinë e Kinën.

Tash mendimi evropian është në provë. Nëse mbetet në linjën e "kompasit strategjik" të Borellit, ai është mendim komik përballë operacionit gjenocidal, "Patkoit" të Putinit, që po synon spastrimin etnik në Ukrainës Lindore dhe kufizimin e sovranitetit të shteteve ish sovjetike dhe të ish bllokut komunist, me doktrinën e Brezhnjev. I paraqitur vetëm një vit para agresionit rus kundër Ukrainës, "kompasi strategjik" për Bashkimin Evropian, me firmën e Zhozep Borellit, tregon se mendimi strategjik në BE është "n'ër lula" siç thuhet shqip, për një gjendje që nuk përkon fare me realitetin. Mendimi strategjik në Bashkimin Evropian dhe në NATO, po edhe në SHBA duhet të riformulohet, duke e rritur vendosmërinë e Perëndimit, duke e mbrojtur më vendosmërisht Ukrainën, në bazë të Marrëveshjes së Budapesit dhe duke e futur Ballkanin me procedura të përshepuara në Bashkimin Evropian dhe në NATO. Dhe duke ua thyer kurrizin politikave pro-ruse kudo të Evropë, veçmas në Ballkan, ku Serbia dhe entiteti Republika Serbe, sillen si vasal të Rusisë.

Brenda makinerisë së madhe të gënjeshtreve në Kremlin

Nga Jeremy FLEMING
"Spectator"

E besoni apo jo, por kanë kaluar 37 ditë nga momenti kur Vladimir Putin nisi një sulm të paprovokuar dhe të paramenduar ndaj Ukrainës. Ky sulm ka qenë tronditëse në çdo kuptim të kësaj fjale. Dhe nuk është aspak për t'u habitur, pasi e kemi parë edhe më herët këtë strategji. Ne pamë në fillim fotot ajrore të shërbimeve sekrete.

Tani po shohim Putinin që po përpiket të zbatojë planin e tij. Por po dështon. Dhe Plani B i tij, ka qenë më shumë sulme barbare kundër civilëve dhe qyteteve ukrainase. Është më se e qartë se ai luan me rregulla të ndryshme morale dhe ligjore. Shumë ukrainas dhe rusë kanë humbur tashmë jetën.

Dhe përtej viktimitave, shumë e shumë të tjerëve u është shkatërruar jeta. OKB-ja vlerëson se në pak më shumë se 1 muaj, më shumë se 10 milionë njerëz janë larguar tashmë nga shtëpitë e tyre. Është një krizë humanitare që nuk duhet të kishte ndodhur kurrë. Dhe mjerisht ende nuk ka mbaruar.

Thënë këtë, gjithnjë e më shumë po vihet re se Putini nuk e ka vlerësuar ashtu siç duhet situatën. Është e qartë se ai e vlerësoi gabim rezistencën e popullit ukrainas. Ai e nënvlerësoi reagimin e koalicionit perëndimor ndaj veprimeve të tij. Nënvlerësoi pasojat ekonomike të regjimit të sanksioneve.

Po ashtu i mbivlerësoi aftësitë e ushtrisë së tij për të siguruar një fitore të shpejtë. Ne kemi parë ushtarë rusë – të keq-armatosur dhe me moralin e dobët – që refuzojnë të zbatojnë urdhrat, që sabotojnë pajisjet e tyre, madje edhe të rrezojnë aksidentalisht avionët e tyre.

Edhe pse ne besojmë se këshilltarët e Putinit kanë frikë t'i thonë atij të vërtetën, ajo që po ndodh, dhe shkalla e këtyre gjykimeve të gabuara, duhet të jetë e qartë për regjimin. Këtë javë, Ministria ruse e Mbrojtjes deklaroi publikisht se do të reduktojnë në mënyrë drastike operacionet luftarake rreth Kievit dhe një qyteti në veri.

U duk sikur rusët ishin detyruar të bënin një ndryshim të rëndësishëm në strategjinë e tyre. Por më pas i vazhduan sulmet në të dyja këto qytete. Mesazhe të përziera apo dezinformata të qëllimshme, do të shohim në vazhdim se cila është e vërteta. Gjithçka i shtohet llogaritjeve të gabuara strategjike, për të cilat Putin u paralajmërua nga udhëheqësit tanë perëndimorë. Kjo është bërë lufta e tij personale, me koston që po paguhet nga njerëz të pafajshëm në Ukrainë



dhe gjithnjë e më shumë edhe nga rusët e zakonshëm.

Sigurisht, ironia e madhe është se me veprimet e tij, Putini ka shkaktuar pikërisht atë që po përpiket të shmangte: një Ukrainë me një ndjenjë të ripërtërirë të kombësisë së saj, një NATO që është sot më e bashkuar se kurrë, dhe një koalicion global kombesh që i dënojnë veprimet e tij.

Pak më shumë se 1 muaj pas fillimit të luftës, është ende herët të listojmë të gjitha pasojat e kësaj krize. Por unë do të përshkruaj disa aspekte që më bien më shumë në sy. Dhe do t'ia filloj me rëndësinë që ka lufta e informacionit. Rusia shkroi manualin e luftës hibride. Mediat shtetërore, mediat online dhe agjentët e ndikimit po përdoren për të fshehur motivet reale, dhe për t'i justifikuar veprimet ushtarake. Ne i kemi parë rusët ta përdorin këtë manual edhe në Siri dhe shumë vende të tjera. Qëllimi i tyre është që të përhapin informacione të rreme.

Të mbjellim mosbesim ndaj fakteve dhe të përforcojnë narrativat e rreme. Ajo synon gjithashtu të garantojë mos-ekspozimin në mediat ruse të asaj që po ndodh realisht në Ukrainë. Ne e dimë që fushata ushtarake Putinit ka shumë probleme: moral të ulët të trupave, probleme logjistike serioze, dhe një numër të lartë viktimitash. Komanda dhe kontrolli i tyre është në kaos të plotë. Ne e kemi parë gjithashtu Putinin t'i gënjejë qytetarët e vendit të tij në një përpjekje për të fshehur paaftësinë e ushtrisë. Dhe e gjitha kjo do të thotë, se ai po tenton një kontroll brutal të medias dhe qasjes në internet.

Ai kërkon shtypjen e çdo zëri opozitar, dhe po bën investime të mëdha në propagandën shtetërore

dhe shërbimet sekrete.

Por sërish i ka bërë llogaritë gabim. Lufta informative e presidentit ukrainas Zelenskyy është treguar shumë më efektive. Fushata e tij duket shumë më e zhdërvjellët, me shumë platforma, multimedia, dhe tejet e përshtatur për audiencat të ndryshme.

Dhe mesazhet e tij mbështeten nga fushata informuese në të gjithë botën. Në Britani, qeveria ka nga ngritur një agjenci të posaçme që identifikon dhe kundërshton dezinformimin e Kremlinit ndaj audiencës ndërkombëtare. Është e qartë se Rusia po përdor mercenarë dhe luftëtarë të huaj për të shtuar numrin e forcave të saj. Këtu përfshihet edhe grupit Wagner që ka qenë aktiv në Ukrainë që nga aneksimi i paligjshëm i Krimesë nga Rusia në vitin 2014.

Grupi funksionon si një degë në hije e ushtrisë ruse, duke u angazhua në operacionet më të rrezikshme. Në fakt këta ushtarë ka të ngjarë të përdoren si mish për top në përpjekje për të kufizuar humbjet ushtarake ruse.

Ndërkohë kemi parë grupe hakerash që janë zotuar për besnikëri ndaj të dy palëve. Kemi parë biznese në të gjithë botën që të distancohen nga ekonomia ruse. Kemi parë angazhimin e kompanive të mëdha për të siguruar funksionimin e internetit në Ukrainë, apo për të demaskuar dezinformimin.

Nga ana tjetër agresioni i Putinit e ka rigjallëruar NATO-n. Lufta ka shkaktuar një përgjigje ndërkombëtare të paprecedentë. 141 vende e dënuan atë në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së. Vendet në të gjithë Evropën po përmbysin qasjet e tyre të vjetra disadkadëshe në politikën e mbrojtjes; duke investuar edhe më shumë në këtë

sektor.

Shumë vende të tjera larg rajonit si Australia dhe Japonia janë rreshtuar kundër Rusisë.

Këto zgjedhje do të ndikojnë në rendin global për dekadat në vijim. Moska ka bërë zgjedhje strategjike duke hyrë në një alenacë të ngushtë me Pekinin, teksa ky i fundit sfidon Washingtonin.


Në krizën aktuale, Rusia e sheh Kinën si një furnitore armësh, si një ofruese të teknologjisë, si një treg për hidrokarburet e saj, dhe si një mjet për të anashkaluar sanksionet. Ne e dimë se të dy presidentët Xi dhe Putin, i kushtojnë shumë rëndësi marrëdhënieve të tyre personale.

Por llogaritjet që bën Xi janë më të nuancuara. Ai nuk e ka dënuar publikisht pushtimin, duke llogaritur që kjo situatë e ndihmon t'i kundërvihet SHBA-së. Dhe duke pasur një sy tek rimarrja e Tajvanit, Kina nuk dëshiron të bëjë asgjë që mund të kufizojë aftësinë e saj për të vepruar në të ardhmen.

Rusia e kupton se në një periudhë afatgjatë, Kina do të bëhet gjithnjë e më e fortë ushtarakisht dhe ekonomikisht. Disa nga interesat e tyre do të bien ndesh; dhe Rusia mund të nxirret jashtë ekuacionit. Dhe është po aq e qartë se një Kinë që dëshiron të diktojë rregullat për një qeverisje të re globale, nuk ndihet aq komode nga aleanca e ngushtë me një regjim që me dashje dhe në mënyrë të paligjshme i shpërfill që të gjitha normat aktuale.

Në sfondin e ndryshimeve historike, po shfaqet një arkitekturë e re e sigurisë globale. I gjithë ky ndryshim do të kërkojë dekada. Por ajo për të cilën mund të jem i qartë tani është se mënyra se si do t'i qasemi këtyre sfidave, do të jetë po aq e rëndësishme sa përgjigja jonë. Bota.al

Marrë me shkurtime



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Gjykata ia refuzon ankesën Gramoz Vokrrit, FFK-ja ndihet fituese

Gjykata Themelore e Prishtinës ia ka refuzuar ankesën Gramoz Vokrrit. I menjëhershëm ka qenë reagimi i FFK-së, e cila pretendon se e drejta është në anën e saj. “Dy aktvendimet e Gjykatës Themelore në Prishtinë vërtetojnë që thirrja e Kuvendit të FFK-së për datën 6 prill 2022 është e ligjshme, si dhe organet e brendshme të FFK-së kanë trajtuar drejt procesin e mbarëvajtjes së Kuvendit të Rregullt dhe Zgjedhor”, thuhet në reagimin e Federatës së Futbollit të Kosovës

“Epoka e re”

PRISHTINË, 4 PRILL - Gjykata Themelore e Prishtinës të hënën ia ka refuzuar ankesën Gramoz Vokrrit. Ky i fundit ishte ankuar në gjykatë, se Kuvendi Zgjedhor i FFK-së është i parregullt. Por, kjo gjykatë e ka vlerësuar të pabazë ankesën e tij. Siç dihet, Gramoz Vokrrit iu pamundësua garimi për kryetar të Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK) për shkak të disa nënshkrimeve të delegatëve të cilat ishin shpallur të pavlefshme. Pas këtij vendimi ka reaguar edhe FFK-ja, e cila pretendon se e drejta ishte në anën e saj. Sipas Federatës së Futbollit, Gjykata Themelore në Prishtinë, me dy vendimet e saj, ka konfirmuar ligjshmërinë e thirrjes së Kuvendit të Rregullt Zgjedhor për kryetar të FFK-së, i caktuar për datën 6 prill.

“Gjykata Themelore në Prishtinë përmes këtyre dy aktvendimeve nuk ka gjetur asnjë shkelje dhe paligjshmëri në lidhje me Kuvendin e FFK-së që do të mbahet me 6 prill 2022 dhe as me kompetencat e sekretarit të FFK-së, në mbarëvajtjen e këtij Kuvendi. Ashtu si kemi qenë të bindur qysh në fillim se organet kompetente të FFK-së kanë bërë thirrjen e Kuvendit në konformitet me normat statutare të FFK-së, ligjet e aplikueshme në Kosovë dhe Statutet e UEFA-së dhe të FIFA-së, po ashtu sot nga të dyja aktvendimet e Gjykatës Themelore në Prishtinë vërtetohet që thirrja e Kuvendit të FFK-së për datën 6 prill 2022 është e ligjshme, si dhe organet e brendshme të FFK-së e



kanë trajtuar drejt procesin e mbarëvajtjes së Kuvendit të Rregullt dhe Zgjedhor”, thuhet në reagimin e FFK-së.

“Ashtu siç kemi qenë të bindur që nga fillimi, FFK është në një proces të rregullt dhe të ligjshëm, dhe se FFK nuk është lëkundur asnjëherë nga e drejta e saj për ta organizuar Kuvendin e Rregullt Zgjedhor me datën 6 prill 2022. Këto aktvendime të Gjykatës Themelore në Prishtinë,

si dhe konfirmimet nga UEFA dhe FIFA, e konfirmojnë angazhimin e FFK-së në rrugën e saj të drejtë dhe ligjore për organizimin e Kuvendit të FFK-së për datën 6 prill 2022”, thuhet në këtë njoftim.

FFK-ja, po ashtu, ka njoftuar se në kuvendin e 6 prillit tashmë e kanë konfirmuar pjesëmarrjen zyrtarë të lartë të UEFA-s, të FIFA-s, të MKRS-së dhe të KOK-ut, të cilat do ta bëjnë monitorimin e këtij kuvendi.

SHKURT

Kuka: Dhuna ndaj portierit, mesazh i keq për sportin në vendin tonë

Trajneri i Kosovës në xhudo, Driton Kuka, ka reaguar për sulmin ndaj portierit të Ballkanit, Stivi Frashëri, në fundin e ndeshjes Gjilani - Ballkani. Kuka ka thënë se dhuna ndaj portierit në ndeshjen futbollistike është mesazh i keq për sportin e Kosovës. Ai ka kërkuar urgjentisht që të dënohet dhe luftohet dhuna në çdo sport. “Pamjet e djeshme dhe dhuna ndaj portierit në ndeshje futbollistike, mesazh i keq për sportin në vendin tonë. Diçka që duhet me urgjencë të dënohet dhe të luftohet në çdo sport dhe kundër çdo personi që pretendon të prish një garë sportive. Pardje isha në ndeshje futbollit U13 dhe te fëmijët pashë një korrektësi mes tyre, një rivalitet sportiv. Tregon punën e mirë dhe edukative të trajnerëve. Ndeshja ishte mes fëmijëve të ekipeve Peja dhe Shqiponja. Ne të tjerët të shohim ndeshje e mos t'i prishim ëndrrat e fëmijëve tanë. Huliganët jashtë sportit, luftë e pakompromis kundër ngjarjeve të tilla”, ka shkruar Kuka.

Berisha, titullar i padiskutueshëm në Torino

Iu deshën vetëm katër ndeshje si titullar në Serinë A për ta fituar formacionin. Etrit Berisha padyshim që po kalon një nga momentet më të mira në karrierën e tij futbollistike. Kapiteni i kombëtares shqiptare ka luajtur si titullar në katër ndeshjet e fundit të Torinos për shkak të një dëmtimi të portierit serb Milinković-Savić dhe ka pësuar vetëm dy gola. Duket se kjo gjë ka bërë që mediet italiane ta cilësojnë gardianin kuqezi si portierin e ri titullar të Torinos. Gazeta online italiane “TuttoMercatoWEB” shkruan: “Torino ka kthyer hierarkitë, Berisha është numri 1 i ri në portë, pas performancës fantastike me Salernitanën, i cili ishte edhe lojtari më i mirë në fushë”.

Sirko, MVP i xhiros së 25-të

Xhiroja e 25-të në Art Motion Superligë dhuroi disa ndeshje mjaft interesante. Takim shumë interesant ishte në mes të Sigal Prishtinës dhe Golden Eagle Yllit, ku fituan therandasit 71:74, me një treshe në fund nga Erjon Kastrati. Basketbollisti me indeksin më të lartë të ndeshjes ishte Henrik Sirko me 20 pikë, pesë kërcime dhe katër asistime. Kjo nuk është hera e parë që ish-basketbollisti i Pejës zgjedhet MVP i xhiros në elitën e basketbollit. Ai u ndihmua nga Mikaile Tmusiq me 14 pikë, nëntë kërcime dhe një asistim. Peja fitoi derbin ndaj rivalës së vjetër, Trepçës, me shifrat 79:71, ku Dardan Berisha u dallua me 26 pikë, një kërcim e tetë asistime. Bashkimi shënoi fitore të vlefshme ndaj Rahovecit 78:67, ku më i dalluari te prizrenasit ishte Terrence Thompson me 14 pikë, nëntë kërcime dhe dy asistime. Prizreni 16 ka shënuar fitore të priturore ndaj Dritës 78:102. Të prizrenasit u dallua Robert McCoy me 12 pikë, dhjetë kërcime dhe dy asistime.

Të enjten zhvillohen gjysmëfinalet e Kupës

PRISHTINË, 4 PRILL - Futbollit në Kosovë nuk pushon, pasi në mesjavë do të zhvillohen ndeshjet e Kupës. Dy ndeshjet e para gjysmëfinale të kësaj gare do të luhen të enjten. Prishtina dhe Llapi do të përballen në mes vete në kryeqytet në duelin kryesor të kësaj faze, kurse ballafaqimi tjetër është ai në mes të Dritës me Ramiz Sadikut. Gjilanasit shihen si favoritë për të kaluar në finale, edhe pse duhet të priten dy përballjet pasi, siç dihet,

në këtë fazë luhet me sistem vajtje/ardhje. Fituesi i Kupës e siguron daljen në Evropë dhe për këtë arsye kjo garë është bërë edhe më interesante dhe më joshëse vitet e fundit. Fitues aktual i Kupës së Kosovës është Llapi.

KUPA E KOSOVËS

**Të enjten takohen:
14:00 Prishtina - Llapi
14:00 Drita - Ramiz Sadiku**



Gjashtë klube fitojnë 'betejën' me Federatën e Notit

Prishtinë, 4 prill - Këshilli i Arbitrazhit Sportiv (KAS), që vepron në kuadër të Komitetit Olimpik të Kosovës, ka shqyrtuar padinë e gjashtë klubeve të notit, Aloha, Delfini, Illyria, Rainca, Niko

dhe Hajvalia të bërë ndaj Federatës së Notit të Kosovës (FNK). Klubet janë drejtuar me padi në KAS për mosanëtarësimin e tyre nga Federata e Notit të Kosovës. KAS, pas shqyrtimit të ankesës dhe

dëgjimit të palëve, ka marrë vendim pro-klubeve. "Aprovet në tërësi si e bazuar padia e paditësve, përfaqësuar nga Besart Shala dhe Agron Zeqiri. Obligohet e paditura, përfaqësuar nga Astrit

Haliti (kryetar i FNK-së), që t'i pranojë dhe t'i regjistrojë gjashtë klubet e notit si anëtare me të drejta të plota në FNK, menjëherë pas pranimit të këtij vendimi", thuhet në vendimin e KAS-it.



Sonte përballen City - Atletico dhe Benfica - Liverpool

MANCHESTER, 4 PRILL - Atletico Madridi për herë të dytë në këtë edicion do ta vizitojë qytetin e Manchesterit. Në fazën e kaluar kjo skuadër është përballur me Manchester Unitedin, kurse sonte (e martë) në çerekfinale të Ligës së Kampionëve i shkon Manchester Cityt në "Etihad". Skuadra e Pep Guardiols kaloi Sportingun e Lisbonës me rezultat të përgjithshëm 5-0, derisa Atletico e eliminoi Unitedin me rezultat të përgjithshëm 2-1. City ishte eliminuar në tri edicione rresht në çerekfinale të Ligës së Kampionëve, derisa vitin e kaluar ishte nënkampion i kësaj gare. Përballja me Liverpoolin në Premier Ligë është më 10 prill, por Pep Guardiola nuk do të lejohet që skuadra të shpërqendrohet nga Liga e Kampionëve. Në anën tjetër, Atletico është i fokusuar maksimalisht në garën më të fortë në futboll, pasi në La Liga e ka humbur hapin dhe nuk do të arrijë të luftojë për ta mbrojtur titullin. Kyle Walker mungon për



vendasit, kurse për mysafirët Yannick Carrasco. Për këtë ndeshje foli edhe trajneri Pep Guardiola, i cili bëri me dije se do të krijojë një strategji të re, pasi nuk pëlqen të luajë gjithmonë në të njëjtën mënyrë. "Do të ishte e mërzitshme nëse do të luaja gjithmonë në të njëjtën mënyrë. Taktika të reja, nesër do të shihni një të re. Mendoj shumë, prandaj kam rezultate shumë të mira në Ligën e Kampionëve. Të gjithë përpiqen ta fitojnë ndeshjen.

Nëse ata fitojnë, ata kanë të drejtë, nëse ne fitojmë ne kemi të drejtë", ka thënë Guardiola. Sonte zhvillohet edhe ndeshja tjetër mes Benficës dhe Liverpoolit. Skuadra angleze është favorite në letër, por portugezët janë të gatshëm për befasi.

Të martën takohen:
21:00 Benfica - Liverpool
21:00 Manchester City - Atletico Madrid

Mick Schumacher kujton aksidentin: Kisha frikë të dilja nga makina

JEDDAH, 4 PRILL - Në garën e fundit të zhvilluar në pistën e Jedas nuk mori pjesë piloti i ri gjerman Mick Schumacher, protagonist i një aksidenti të frikshëm të shtunën, gjatë provave zyrtare. Makina e tij Haas u shkatërrua totalisht, por të gjithë ishin në ankth për gjendjen e pilotit, që më pas u transportua në spital dhe nuk mori pjesë në garë. "Në momentin e parë pas aksidentit nuk doja të dilja nga makina. Kisha frikë dhe e dija se pas meje do të vinin makina të tjera. Kontrollova nëse çdo gjë ishte në rregull dhe u qetësova kur pashë që nuk kisha pësuar dëmtime", ka thënë Schumacher. Piloti gjerman nuk arrinte të komunikonte me skuadrën, pasi



ishite dëmtuar radio, duke bërë që ankthi të ishte i madh. Gjithsesi, gjithçka shkoi mirë dhe piloti 23-vjeçar, djali i legjendës Michael

Schumacher (7 herë kampion bote në Formula 1), do të jetë normalisht në pistë këtë fundjavë në garën e Australisë.

Inzaghi: Fitorja ndaj Juventusit largon presionin

Fitore shumë të rëndësishme mori Interi një ditë më parë, ndërkohë që trajneri Simone Inzaghi për DAZN deklaroi: "Tri pikët janë shumë të rëndësishme. Kemi lënë pikë që do të përpiqemi t'i fitojmë në këto tetë ndeshjet e

mbetura. Kjo fitore shërben për ta larguar presionin, edhe pse nuk ndiej. Është normale që Interi të jetë nën presion pas pikëve të lëna në ndeshjet e fundit, por na kanë munguar lojtarë të rëndësishëm. Tani do të thonë

që jemi ende favoritë, por nuk kishim fituar në këtë stadium prej 11 vjetësh. Kjo fitore duhet të na japë besim në ndjekjen e Milanit dhe Napolit. Kam një kontratë, që klubi më ka kërkuar ta zgjas. Kërkoja të pres sepse duhet t'i

vlërësojmë rezultatet. Shtatë muaj punë e shkëlqyer janë megjulluar nga rezultatet e fundit, por ndiej besimin e të gjithëve. Kritikata janë të pranishme, por unë kam 30 vjet në futboll dhe është e drejtë t'i pranosh kritikata

konstruktive. Penalltia? Ishte penalltia, sikur ishte edhe goli i Calhanoglu më pas. Penalltia nuk do të përsëritej. Në ndeshjen e parë hoqa xhakatën dhe u përjashtova, tani hesht", u shpreh trajneri Inzaghi.

SHKURT

Mbappe: Ka mundësi të qëndroj në PSG

Sulmuesi Kylian Mbappe ka folur pas ndeshjes së PSG-së në kampionat dhe sigurisht tema më e prekshme është ajo e të ardhmes. Sulmuesi foli edhe për eliminimin nga Liga e Kampionëve. "Po, ka mundësi të qëndroj. Nuk kam vendosur ende. Jam i qetë, dua të marr kohë që të mos gaboj. Së bashku me familjen do ta marr vendimin më të mirë. Ta ndiesh dashurinë e tifozëve kështu është gjithmonë mirë dhe i falënderoj", ka thënë Mbappe. "Eliminimi nga Liga e Kampionëve? Kam gjithmonë të njëjtin mentalitet dhe vetëm një qëllim: për ta ndihmuar ekipin tim të fitojë. Në Madrid humbëm të gjithë. Jemi të gjithë në një varkë dhe të gjithë kemi gabuar", ka shtuar Mbappe.

Barça e ka seriozisht interesimin për Lewandowskin

Robert Lewandowski prej ditësh është në qendër të vëmendjes për një kalim nga Bayern Muncheni te Barcelona në përfundim të këtij sezoni. Polaku ka edhe një vit kontratë me kampionët në fuqi të Gjermanisë, por dëshira e tij është të provojë një përvojë të re në La Liga. Barcelona është klubi që po tenton me ngulm ta afrojnë në skuadër Lewandowskin, madje ka edhe një plan konkret. Katalanasit janë të gatshëm të ofrojnë në këmbim një lojtar që Bayerni ka tentuar më parë, mbrojtësin Sergino Dest. Gjermanët duhet të vendosin kur ta marrin ofertën.

Serena Williams: Jam përmirësuar sa herë që kam humbur

Tenistja amerikane Serena Williams ka folur për karrierën e saj dhe marrëdhënien që ka me humbjen. "Është e vështirë ta pranosh humbjen. Unë e përjetoj shumë keq momentin e humbjes, madje e urrej atë fjalë", shprehet Serena Williams, fituese e 23 grand slameve në karrierë. "Gjithsesi, përpiqem të mësoj sa më shumë nga humbja. Madje mendoj se disa nga momentet e mia më të mira në këtë sport kanë ardhur pas humbjeve. Kam arritur të përmirësohem më shumë", shprehet Serena Williams. Duke folur për të ardhmen, ajo shprehet se tashmë i ka vendosur limite vetes, duke parë se është 40 vjeçe. "Ka pasur një periudhë në karrierën time kur nuk vendosja limite, por mendoj se tani ato limite janë të rëndësishme. Mendoj se këto do të më ndihmojnë në rikthimin tim", ka thënë tenistja ikonë e 20 viteve të fundit.

Klopp: Supersfida e së dielës vendos titullin

Manchester City dhe Liverpooli, aktualisht të ndarë me vetëm një pikë në renditje, janë gati për t'i qeruar hesapet në përballjen direkte për titull të dielën. Një sfidë vendimtare që Pep Guardiola e prezantoi si vijon: "Duhet ta ndiejmë presionin të tillë: nëse humbim këtë ndeshje nuk do ta fitojmë kampionatin. Shpresojmë ta mposhtim Liverpoolin. Duhet ta menaxhojmë presionin në mënyrën e duhur. Ne do të përgatitemi në mënyrën më të mirë të mundshme". "Qytetarët" i pret "nyja gordiane" e sezonit, fillimisht ndaj Liverpoolit në Premier Ligë, më pas ndaj Atletico Madridit në Ligën e Kampionëve. Nga ana tjetër, Jurgen Kloppi ëndërron parakalimin. "Për të vazhduar luftën për titull, ne duhet ta fitojmë ndeshjen kundër Manchester Cityt. Përndryshe do të jetë shumë e komplikuar. Ndeshja e ardhshme e Premier Ligës do të jetë shumë e rëndësishme. Ne nuk fshihemi. Së pari, megjithatë, duhet t'i luajmë çerekfinalet e Ligës së Kampionëve me Benficën. Kemi vetëm tri ditë në dispozicion, më pas do të mendojmë për Cityn", ka deklaruar Klopp.



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVA



INSTITUTI I HISTORISË "ALI HADRI" - PRISHTINË
INSTITUTE OF HISTORY "ALI HADRI" - PRISHTINA
INSTITUT ZA ISTORIJU "ALI HADRI" - PRIŠTINA

Datë, 05.04.2022

Në bazë të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), neni 30, Statutit të Institutit të Historisë "Ali Hadri" në Prishtinë, neni 32, Ligjit të Punës nr. 03/L212, Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017, për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, dhe Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve të Institutit të Historisë, shpallë:

KONKURS

- 1 (Një) Këshilltar shkencor për periudhën e mesjetës - zgjedhje/rizgjedhje
- 1 (Një) Bashkëpunëtor i lartë shkencor për periudhën e shek.XX – zgjedhje/rizgjedhje
- 1 (Një) Bashkëpunëtor i lartë shkencor për periudhën e shek.XVI-XVIII - zgjedhje/rizgjedhje
- 1 (Një) Bashkëpunëtor i lartë shkencor për periudhën e antikës – zgjedhje/rizgjedhje
- 1 (Një) Bashkëpunëtor shkencor për periudhën e shek.XX – zgjedhje

Kandidatët për Këshilltar shkencor (prof. dr.) duhet t'i plotësojnë këto kushte:

- Të ketë shkallen e doktorit të shkencave,
- Të ketë të botuar së paku 5 (pesë) punime shkencore në revista relevante ndërkombëtare në kuadër të periudhës së përcaktuar (si autor i parë), të cilat duhet të jenë të njohura sipas Rregullores në fuqi. Së paku dy (2) prej tyre duhet të jenë pas zgjedhjes së fundit
- Të ketë të botuara monografi shkencore nga fusha përkatëse
- Të ketë marrë pjesë në aktivitete shkencore brenda dhe jashtë vendit
- Të ketë pjesëmarrje me kumtesa së paku në tri (3) konferenca, nga të cilat së paku një (1) të jetë ndërkombëtare

Kandidatët për Bashkëpunëtor të lart shkencor (prof.asoc.) duhet t'i plotësojnë këto kushte:

- Të ketë shkallen e doktorit të shkencave,
- Të ketë të botuar së paku tri (3) punime shkencore në revistat relevante ndërkombëtare në kuadër lemisë,
- Të ketë të botuara monografi shkencore nga fusha përkatëse
- Të ketë marrë pjesë në aktivitete shkencore brenda dhe jashtë vendit,
- Të ketë pjesëmarrje me kumtesa së paku në dy (2) konferenca, nga të cilat së paku një (1) të jetë ndërkombëtare

Kandidatët për Bashkëpunëtor shkencor (ass.prof.) duhet t'i plotësojnë këto kushte:

- Të ketë shkallen e doktorit të shkencave,
- Të ketë të botuar së paku një (1) punim shkencor në ndonjë revistë relevante ndërkombëtare në kuadër të lemisë. Punimet duhet të jenë të njohura sipas Rregullores në fuqi.
- Të ketë marrë pjesë në aktivitete shkencore brenda dhe jashtë vendit,
- Të ketë të botuara monografi shkencore nga fusha përkatëse

Dokumentacioni i nevojshëm

Kandidati/ja duhet të dorëzojë dokumentacionin si vijon:

- Diplomën për përfundimin e studimeve përkatëse,
- Certifikatën e lindjes jo më të vjetër se gjashtë muaj,
- Dokument të lëshuar nga organi kompetent me të cilin dëshmohet që nuk janë nën hetime,
- CV të së cilës duhet t'i bashkëngjiten dëshmitë e nevojshme për të vërtetuar gjendjen e paraqitur në të.
- Dëshmi për të arriturat shkencore (artikuj, libra, etj)

Zgjedhja e personelit të Institutit të Historisë "Ali Hadri" bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, dhe Statutit të Institutit të Historisë "Ali Hadri".

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në njërin nga gazetat ditore. Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës për të cilin konkurrojnë.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor nga Instituti, dhe janë të obliguar të sjellin me vete dokumentet origjinale mbi kualifikimet dhe trajnimet e kryera për verifikim para Komisionit.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në këtë nr. tel: 038/512-303, prej orës 09:00 - 16:00.

Aplikacionet e kompletuara dorëzohen në adresën: Instituti i Historisë në Prishtinë, (Ndërtesa e re e Institutit të Historisë në afërsi të Institutit Albanologjik të Prishtinës).



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVA



INSTITUTI I HISTORISË "ALI HADRI" - PRISHTINË
INSTITUTE OF HISTORY "ALI HADRI" - PRISHTINA
INSTITUT ZA ISTORIJU "ALI HADRI" - PRIŠTINA

Datë, 05.04. 2022

Na osnovu Zakona br. 04/L-135 o naučnoistraživačkoj djelatnosti - (Službene Novine Republike Kosova, br 11/02 Maj 2013), Član 30, Statuta Instituta za Istoriju "Ali Hadri" u Prištini, član 33 stav 5, član 51 i 52 obavljuje, Zakon Br. 03/L-212 o Radu, Administrativno Uputstvo (MRSZ) BR.07/2017 o regulisanje procedura konkursa na javnom sektoru, i Uredba o postupcima za izbor i reizbor naučnih radnika i istraživača Instituta za istoriju, objaviti:

KONKURS

- 1 (Jedan) Naučni savetnik za srednjovekovni period - izbor/reizbor
- 1 (Jedan) Viši naučni saradnik za period XX vekove – izbor/reizbor
- 1 (Jedan) Viši naučni saradnik za period XVI-XVIII vekove – izbor/reizbor
- 1 (Jedan) Viši naučni saradnik za period antike – izbor/reizbor
- 1 (Jedan) Naučni saradnik za XX vekove – izbor

Kandidata za naučnog savetnik (Prof.dr.) moraju ispuniti ove uslove:

- Da ima doktorske nauke, za navedeni period.
- Imaju najmanje pet (5) naučnih radova objavljenih u relevantnim međunarodnim časopisima iz odgovarajuće oblasti (kao prvi autor), u skladu sa važećim propisima. Najmanje dva (2) od njih moraju biti nakon poslednjih izbora.
- Da je objavio naučne monografije iz odgovarajuće oblasti
- Da je učestvovao u naučnim aktivnostima unutar i izvan zemlje
- Da učestvuje sa referatima na najmanje tri konferencije, od kojih je najmanje jedna (1) međunarodna

Kandidata za poziciju Viši naučni saradnik (Prof.asoc.) mora ispuniti sledeće uslove:

- Da ima doktorat nauka,
- Imati najmanje tri (3) naučne radove objavljena u relevantnim međunarodnim časopisima unutar oblasti,
- Da je objavio naučne monografije iz odgovarajuće oblasti
- Da je učestvovao u naučnim aktivnostima unutar i izvan zemlje
- Da učestvuje sa referatima na najmanje dva (2) konferencije, od kojih je najmanje jedna (1) međunarodna

Kandidata za naučnog saradnika (Ass.dr.) moraju ispuniti ove uslove:

- Da ima doktorske nauke, za navedeni period.
- Imaju najmanje jedan (1) naučnih rad objavljenih u relevantnim međunarodnim časopisima unutar oblasti. Radovi moraju biti priznati prema važećim propisima.
- Da su uspešno učestvovali u organizaciji naučnih aktivnosti.

Potrebna dokumentacija

Kandidat mora da dostavi sledeću dokumentaciju:

- Diplomiu za završetak doktorskih studija,
- Izvod iz matične knjige rođenih koji nije stariji od šest meseci,
- Dokument izdat od nadležnog organa koji potvrđuje da nisu pod istragom,
- CV o čemu mora priložiti neophodne dokaze kako bi se dokazala situacija u njoj.
- Dokazi o naučnim dostignućima (članci, knjige itd.)

Izbor osoblja Instituta Istorija " Ali Hadri " bira se u skladu sa odredbama Zakona br . 04 / L - 135 za istraživačke- naučne aktivnosti - i Statuta Instituta Istorije "Ali Hadri " .

Rok za prijavu je 15 dana od dana objavljivanja u dnevnom novinama, Aplikaciji se prilažu (dodajte) kopije dokumentacije o kvalifikaciji, iskustvu i drugoj potrebnoj dokumentaciji koju zahteva radno mesto za koje se aplicira.

Kandidati izabrani na izbornoj listi će biti obavesteni u pisanom obliku ili putem telefona u zakonskom roku Instituta i dužni su da sa sobom daju originalne dokumente o kvalifikacijama i obuci koja se provode za verifikaciju pred Komisijom.

Za detaljnije informacije možete se obratiti na ovom Br . Tel: 038 / 512 303, od 09:00 do 16:00 časova.

Kompletirani zahtevi dostavljaju se na adresu: Institut Istorije u Prištini, (Novi Objekat u blizini Instituta Albanologjik i Prishtinës).



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVA



INSTITUTI I HISTORISË "ALI HADRI" - PRISHTINË
INSTITUTE OF HISTORY "ALI HADRI" - PRISHTINA
INSTITUT ZA ISTORIJU "ALI HADRI" - PRIŠTINA

Datë, 05.04.2022

Në bazë të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), Neni 25 paragrafi 1, Statutit të Institutit të Historisë "Ali Hadri" në Prishtinë, Neni 23 paragrafi 1, Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur me datën 29/03/2022 mori vendimin për shpalljen e konkursit për:

Drejtor të Institutit të Historisë "Ali Hadri"

Kandidatët duhet t'i plotësojnë kushtet si në vijim:

1. Të jetë doktor i shkencave të historisë, përkatësisht t'i plotësojë kushtet për t'u zgjedhur së paku në titullin bashkëpunëtor i lartë shkencor.
2. Të ketë përvojë dhe aftësi të dëshmuara në organizimin dhe udhëheqjen e punëve kërkimore-shkencore.
3. Kandidati, me rastin e konkurrimit duhet të paraqesë projektin për zhvillimin e punës kërkimore-shkencore, si dhe të mirëvajtjes së punëve të tjera në Institut.

Kandidatët së bashku me kërkesë, duhet t'i paraqesin këto dokumente:

- Biografinë e shkurtër,
- Certifikatën e lindjes jo më të vjetër se gjashtë muaj,
- Përmbledhjen e përvojës menaxheriale, dhe përvojës kërkimore-shkencore,
- Dokument të lëshuar nga organi kompetent me të cilin dëshmohet që nuk janë nën hetime.

Zgjedhja e drejtorit të Institutit të Historisë "Ali Hadri" bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, dhe Statutit të Institutit të Historisë "Ali Hadri".

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda 4 ditësh, kurse aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkon pozita për të cilin konkurrojnë.

Për informata të hollësishme mund të kontaktoni në këtë nr. tel: 038/ 512 - 303, prej orës 08:00 - 16:00.

Aplikacionet e kompletuara dorëzohen në adresën: Instituti i Historisë në Prishtinë, (Ndërtesa e re e Institutit të Historisë në afërsi të Institutit Albanologjik të Prishtinës).

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e publikimit.



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVA



INSTITUTI I HISTORISË "ALI HADRI" - PRISHTINË
INSTITUTE OF HISTORY "ALI HADRI" - PRISHTINA
INSTITUT ZA ISTORIJU "ALI HADRI" - PRIŠTINA

Datë, 05.04.2022

Na osnovu Zakona br. 04/L-135 o naučno istraživačkoj delatnosti - (Službeni List Republike Kosova, br. 11/02 Maja 2013), člana 25 tačka 1, člana 23 tačka 1 Statuta Instituta za Istoriju "Ali Hadri" u Prištini, Upravni odbor na sednici održanog 29.03.2022 doneo odluku da raspisuje konkurs:

Za izbor direktora Instituta Istorije "Ali Hadri"

Na konkurs za izbor direktora može se javiti kandidat koji ispunjava sledeće uslove:

1. Da je doktor istorijskih nauka, odnosno da ispunjava uslove da bude izabran najmanje u zvanje višeg naučnog saradnika.
2. Da kandidat ima iskustvo u rukovođenju naučnog-istraživačkog rada.
3. Kandidat treba da predstavlja predlog programa naučnog-istraživačkog rada i drugih rada na Institut.

Potrebna dokumentacija:

- Kratka biografija;
- Izvod iz matične knjige rođenih, ne stariji od šest meseci;
- Rezime menadžerskog i istraživačkog iskustva;
- Uverenje izdata od strane nadležnog organa kojim se dokazuje da se protiv kandidata ne vodi se istraga;

Direktor Instituta Istorija "Ali Hadri" bira se u skladu sa odredbama Zakona br. 04 / L - 135 za naučno istraživačkoj delatnosti - i Statuta Instituta Istorije "Ali Hadri".

Prijave poslate poštom, na kojima se nalazi poštanski žig na dostavi izvršenoj poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se važećim i razmatraće se ukoliko stignu u roku od 4 dana, dok prijave koje stignu nakon ovog roka i one nepotpune neće biti uopšte razmatrane.

Rok za prijavu je 15 dana od dana objavljivanja u dnevnim novinama, Aplikaciji se prilažu (dodajte) kopije dokumentacije o kvalifikaciji, iskustvu i drugoj potrebnoj dokumentaciji koju zahteva radno mesto za koje se aplicira.

Za detaljnije informacije možete se obratiti na ovom Br. Tel: 038 / 512 303, od 09:00 do 16:00 časova. Kompletirani zahtevi dostavljaju se na adresu: Institut Istorije u Prištini, (Novi Objekat u blizini Instituti Albanologjik i Prishtinës).

Konkurs ostaje otvoren 15 dana od dana objavljivanja.



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë

Rr"Motrat Qiriazit" Nr. 29, Ulpianë 10000 Prishtinë – Kosovë, www.kolegijibiznesi.com,
info@kolegijibiznesi.com | Tel: +383 38 500 878 | +383 44 500 878 | +383 45 500 878

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitave të nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës Nr.04/L-037, si dhe në mbledhjen e Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të datës: **25.03.2022**, të Kolegjit "BIZNESI" Prishtinë:

SHBALL KONKURS PËR PRANIMIN E STAFIT AKADEMIK

I. PROFESORA

1. **Tre (3)** mësimdhënës me orar të plotë pune në programin - **JURIDIK LLB**,
2. **Tre (3)** mësimdhënës me orar të plotë pune në programin - **MENAXHIMI I EMERGJENCAVE – MA**,

Zgjedhja e personelit akademik do të bëhet në pajtim me dispozitat e Statutit të Kolegjit BIZNESI.

Për vendin e punës mësimdhënës, kandidatët e interesuar duhet të kenë të përfunduar doktoratën në lëmin përkatës dhe punime në revistat si SCOPUS dhe WEB OF SCIENCE (për piken e par duhet ta kenë nga një punim kurse për piken e dytë nga dy punime).

Njohja e gjuhës angleze apo e ndonjë gjuhe tjetër të huaj është përparësi për aplikantët.

Kandidatët që paraqiten në konkurs duhet ti paraqesin këto dokumente: Kërkesën me biografi (CV), Kopjen e diplomës përkatëse të noterizuar (vërtetuar), Certifikatën e lindjes, Kopjen e letërnjoftimit.

(Fushat për piken dy duhen me qen :Menaxhimi i emergjencave, Mbrojtja e ambientit, mbrojtja e mjedisit, fusha e ujërave, mbrojtja në punë, klimatologji, gjeologji, kimi, biologji, shkenca te natyrës,...etj)

Kandidatët që kanë doktoruar jashtë vendit duhet të sjellin edhe dëshmi për nostrifikimin e diplomës përkatëse nga MASHT-i, në të kundërtën, dosja e aplikantit do të konsiderohet e pakompletuar.

Konkursi mbetet i hapur nga **05.04.2022 deri më 15.04.2022**.

Paraqitja e dokumenteve: Rr.Motrat Qiriazit 29, 10000 Prishtinë, Kosovë ose përmes e-mail: info@kolegijibiznesi.com

Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në web faqen: www.kolegijibiznesi.com

Aplikacionin mund ta shkarkoni në ueb faqen: www.kolegijibiznesi.com ose mund ta merrni në zyrat e Kolegjit BIZNESI.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "KLEKOS" SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810810350 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "KLEKOS" D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810810350 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "KLEKOS" L.L.C. has come to the decision to quit its business: 810810350 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM ZBRITJE MALLI DERI 75 %

Biznesi individual me numër Unik Identifikues 810497398 me seli në Llapna Sell dhe nr. kontakti 044777778, për arsye të likuiditetit, njofton të interesuarit qytetarë si persona fizik apo juridik mund të blejnë produkte kozmetike grimi të brendeve botërore MAX FACTOR, ARTDECO, parfuma, deodorante, qumësht trupi etj, të firmave botërore BOSS, BALDESSARINI, D&G, Lacoste, Moschino, Valentino, Versace, ngjyra flokësh, pajisje tretmani dhe mirëmbajtje floku të prodhuesit Italian DIKSON.

Lokali me qira

Lëshohet lokali me qira. Lokali ka 75 m2. Lokali gjendet tek "REB BULLI", në Prizren. Për informata mund të na kontaktoni në këta numra të telefonit:
044-514-373 dhe 044-199-707.

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Sanije M. Shabani B.I. me Emri Tregtar: D.P.T. "MEDINA" me seli në Adresa: Çagllavicë, Zona Industriale p.n. Komuna: Prishtinë shpall të pavlefshme Certifikatën e biznesit me NRB: 70622092 të lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.
- ▶ Nakije Baliushpall të pavlefshme Licencën me nr. KO-00646-01-12- në OMK-Kosovë.
- ▶ Arsim Mjeku B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810384644.
- ▶ Teuta Shunjaku nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.
- ▶ Sef Pnishi nga Gjakova, shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkohet një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalit me qira. Lokali është i pasitur me të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajazitit, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- ▶ Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- ▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.
- ▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira, në lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

